

## SHENIME SHPJEGUESE

**Shoqeria SHA UJESJELLES BULQIZE** eshte rregjistruar si shoqeri aksionere me objekt kryesor te veprimtarise **Prodhim dhe shitje uji**.

Kapitali themelimit te shoqerise eshte 58.552.000 leke me Aksionar te vetem Bashkia Bulqize.

Me Vendim te Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes (emri i meparshem Ministria e Ekonomise Publike dhe te Privatizimit) nr. 989, date 14.12.2007 per ndryshimin e Statutit te shoqerise SHA Ujesjelles Bulqize dhe ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.2007 "Per disa ndryshime ne Ligjin nr 7926, date 20.04.1995" eshte vendosur transferimi i aksioneve nen varesine e qeverisjes vendore.

Sipas ketij vendimi aksionet e sha Ujesjelles Bulqize zoterohen 100% nga Bashkia Bulqize e drejte e cila ka kaluar sipas vendimit nr 663 date 27.01.2016 "Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem ne perputhje me ligjin nr.115/2014"Per ndarjen teritoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise"

Asambleja e aksionareve drejtohet nga Kryetari i Bashkise sikurse parashikohet me hyrjen ne fuqi te vendimit per riorganizimin e ri teritorjal. Anetaret e keshillit mbikqyres zgjidhen ne baze te statutit te shoqerise. Shoqeria eshte rregjistruar prane organeve tatimore Bulqize me NIPT J66702422U. Selia e shoqerise eshte Lagjia Minatori, Bulqize.

### ***I. POLITIKA KONTABEL***

- Njesia ekonomike per hartimin e pasqyrave financiare per periudhen 01/01/2019–31/12/2019 eshte mbeshtetur ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit te permisuara.
- Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte sipas natyres dhe eshte hartuar sipas te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.
- Pasqyra e fluksit te parase eshte paraqitur me metoden direkte.
- Mjetet monetare ne arke dhe banke jane raportuar me vleren e drejte.
- Kerkesa te tjera te arketueshme afat shkurtera jane paraqitur me vleren e tyre neto te realizueshme.
- Aktivitet afat gjata materiale jane paraqitur me vleren kontabel te mbetur.
- Detyrimet tatimore afat shkurtera jane paraqitur me vleren e tyre neto te realizueshme.
- Fitim/humbja e vitit raportues eshte e barabarte me fitimin e raportuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.
- Pasqyrat financiare krahasuese te vitit 2019 jane pregatitur sipas kerkesave ekzistuese te kontabilitetit.

## II . SHENIMET QE SHPJEGOJNE ZERAT E PASQYRAVE KRYESORE.

### A – Pasqyra e pozicionit financiar

#### - Aktivet Afatshkurtera

**A1.Aktivet monetare**, perfaqesojne gjendjen ne Banke Raiffeisen Bank ne leke,e cila rezulton me 31 Dhjetor 2019 ne shumen 1.009.942 leke.

#### **A.2.Te drejta te arketueshme.**

Ne kete klase perfshihe gjendja e kerkesave per arketim nga:  
-Klientet ne vleren 35.891.585 leke.

-TVSH ne vleren 286.148 leke.

#### **A.3.Inventare**

Ne kete ze perfshihet vlere e inventarit ne fund te vitit ne shumen 1,416,448 leke dhe shpenzime te shtyra ne shumen 553.963 leke.

#### - Aktivet Afat gjata

#### **A.5. Aktivet afat gjata materiale.**

Vlera kontabile e aktiveve afatgjata materiale ne 31.12.2019 paraqitet me vlere neto 599.194.161 Leke, te pakesuara nga amortizim i akumuluar dhe perfaqesohet nga:

|                         |                  |
|-------------------------|------------------|
| -Toka .....             | 2.452.800 Leke   |
| -Ndertesa.....          | 768.035 Leke     |
| -Instalime teknike..... | 584.485.485 Leke |
| -Pajisje pune .....     | 5.373.230 Leke   |
| -Mjete transporti.....  | 557.293 Leke     |
| -Pajisje zyre.....      | 900.134 Leke     |
| -Punime ne process..... | 4.225.100 Leke   |

Ne zbatim te reformës administrative-territoriale me qëllim rioorganizimin e njësive të qeverisjes vendore dhe me Vendim te Keshillit Bashkiak Bulqize eshte vendosur vleresimi i aseteve, linjave dhe depove ne pronesi te Komunave dhe te Bashkise Bulqize, perpara procedures se transferimit te ketyre asete ne pronesi te Bashkise Bulqize. Nga studio “Erald-G” sh.p.k. shoqeri vleresuese pasurishu hartuar raporti i vleresimit te ketyre aseteve pas dates se mbylljes se pasqyrave financiare 2018. Ne zbatim te Ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare” per zmadhimim e kapitalit ne natyre, ne kete rast, transferimi i aseteve nga Komunat ne Bashkine Bulqize, pas rivleresimit te aseteve eshte bere vleresimi i kontributit ne natyre nga nje shoqeri audituese Alb Auditing &Co shpk.

Vlera e amortizimit te akumuluar per Instalime teknike dhe pajisje eshte shuar ne kunderparti te vleres kontabel te ketyre aktiveve.

Gjate vitit 2019 shtesat e zerave jane:

Zeri Ndertesa eshte shtuar ne shumen 440.000 leke per punime riparime;

Zeri Pajisje informatike ne Shumen 470.000 leke per blerje kamera sigurie

Zeri Pajisje zyre ne Shumen 10.000 leke per blerje rafte.

Zeri Punime ne process Punime emergjente ne rrjet ne Shumen 4.225.100 leke

Ne total shtesa bruto e aktiveve per blerje eshte ne Shumen **5.145.100 leke**

**I. Detyrimet afatshkurtra.**

Ne kete ze perfshihen:

**A.4.** Te pagueshme ndaj furnitoreve ne shumen 29,890,615 leke, te detajuara si me poshte:

|   |                      |                   |
|---|----------------------|-------------------|
| 1 | RES 03               | 21,481,918        |
| 2 | Egland shpk          | 1,559,160         |
| 3 | Shpresa Brecani      | 252.000           |
| 4 | ALB-LEAA INVESTIMI   | 6,499,375         |
| 5 | Energji dhjetor 2019 | 98,162            |
|   | <b>Totali</b>        | <b>29,890,615</b> |

**A.5.** Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurime ne shumen 1.428.900 leke te detajuara si me poshte:

|                                     |                  |
|-------------------------------------|------------------|
| Paga punonjes                       | 1.028.256        |
| Sigurime+ tatimi muaji Dhjetor 2019 | 400.644          |
| <b>Totali</b>                       | <b>1.428.900</b> |

**A.6.** Te pagueshme per detyrime tatimore ne shumen 2,904,577 leke te detajuar si me poshte:

|                                                     |                  |
|-----------------------------------------------------|------------------|
| Sigurimet shoqerore dhe shendetsore te prapambetura | 2.834.596        |
| Tatim fitimi 2019                                   | 87.458           |
| <b>Totali</b>                                       | <b>2.922.054</b> |

**Detyrimet afatgjata.****A.7. Te ardhurat e shtyra (Grandet)**

Grande ne shumen 59.336.638 Leke perfaqesojne subvencionet per investime. Gjate vitit 2019 nuk ka patur shtesa te Grandeve, por ka patur pakesim te Grand per shpenzim amortizimit te aktiveve.

**A.8. Kapitali**

Gjendja e kapitalit eshte si me poshte:

|                                |                  |
|--------------------------------|------------------|
| Kapitali aksionar .....        | 58.552.000 leke  |
| Rezerva rivleresimi.....       | 504.140.509 leke |
| Rezerva statutore.....         | 18.767.713 leke  |
| Humbje e mbartur.....          | (37.181.780)leke |
| Fitimi i vitit ushtrimor ..... | 495.598 leke     |

Gjendja me 31.12.2019 e kapitaleve te veta eshte **544.774.040 leke.**

**Pas rivleresimit te aktiveve, me Vendim te Keshillit Bashkiak Bulqize** eshte vendosur zmadhimi I kapitalit, procedure e cila ka filluar por ende nuk eshte realizuar regjistrimi deri ne daten e mbylljes se pasqyrave financiare, prandaj Rivleresimi eshte pozicionuar ne rezerva per rivleresim, persa kohe nuk eshte transferuar ne capital ne regjistrin e aksioneve.

**B- Pasqyra e Performances**

**B.1.** Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit perfaqesojne shitjet nga faturimi i ujit te pijshem gjate vitit ne shumen **29.055.461 leke.**

**B.2.** Te ardhurat nga kontratat e reja, nga kamatvonesat dhe tarifa e sherbimit jane 2.414.909 leke.

**B.3. Materialet e konsumuara,** ne shumen 3.645.325 leke perfaqesojne mallrat e konsumuara ne funksion te veprimtarise.

**B.4. Kosto e punes shoqeria** ne shumen 18.951.512 leke te cilat perfaqesojne:

- shpenzimet per pagat ne shumen 15.039.926 leke;
- per sigurimet shoqerore & shendetsore ne shumen 2.511.669 leke;
- te tjera personeli ne total 1.399.917 leke nga te cilat keshilli mbikqyres ne shumen 835.800 leke, shperblime punonjesish ne shumen 94.117 leke, shpenzime dieta punonjesish ne shumen 470.000 leke.

**B.5. Amortizimi dhe Zhvleresimet** ne shumen 116.519 leke. Normat e amortizimit te perdorura jane ato manaxheriale.

**B.6.Shpenzime te tjera shfrytezimit**

Ne kete ze te bilancit jane pasqyruar te gjitha shpenzimet e tjera me nje vlere totale **10.551.476** leke qe jane kryer gjate periudhes te vitit 2019 per energji, nafte, shpenzime sherbim roje private, auditim i pasqyrave financiare, shpenz postare dhe telefoni etj.

|                                               |                   |
|-----------------------------------------------|-------------------|
| -Sherbimi i auditimit te pasqyrave financiare | 210,000           |
| -Taksa te ndryshme                            | 119,000           |
| -Energji elektrike                            | 773,488           |
| -Shpenzime telefonie                          | 54,000            |
| -Shpenzime postare                            | 10,340            |
| -Roje private                                 | 6,693,823         |
| -Riparim mirembajtje automjeti                | 53,100            |
| -Mirembajtje rrjeti;                          | 2,107,725         |
| -Procese gjyqesore                            | 480,000           |
| -Punonjes me kontrate                         | 230,000           |
| <b>Totali i shpenzimeve</b>                   | <b>10,551,476</b> |

**B.7. Te ardhura te tjera**

Ne kete ze te bilancit paraqitet te ardhura te tjera financiare si:

-Te ardhurat nga subvencionet, ne shumen 2.264.000 Leke perfaqesojne te ardhurat nga Grandet nga Bashkia per mbulimin e shpenzimeve te aktivitetit te shfrytezimit. Te ardhura per rimarrje amortizimi ne shumen 116,519 leke.

**B.8. Tatim mbi fitimin**

Ne kete ze jane paraqitur llogaritja e tatimit mbi fitimin ne shumen prej 87.458 leke, si 15% e fitimit te tatueshem prej 583.056 leke.

### B.8. Tatim mbi fitimin

Ne kete ze jane paraqitur llogaritja e tatimit mbi fitimin ne shumen prej 87.458 leke, si 15% e fitimit te tatueshem prej 583.056 leke.

### B.9 Deklarata e Tatim Fitimit

Ne deklaraten e tatimit fitimit ne te ardhurat jane perfshire:

Te ardhurat nga shitja sipas FDP ne shumen..... 29.055.461 leke

Te ardhura nga tarifa e kontrata ne shumen..... 2.414.909 leke

Te ardhura Grand per shpenzime ne shumen ..... 2.264.000 leke

**Total te ardhurat ne deklarata ne shumen .....33.734.370 leke.**

Ne deklaraten e tatimit fitimit ne shpenzime jane perfshire:

Shpenzime mallra ne shumen ..... 3.645.325 leke

Shpenzime personeli ne shumen ..... 18.951.512 leke

Shpenzime te tjera ne shumen ..... 10.551.476 leke

Shpenzime financiare ne shumen ..... 3.000 leke

**Total shpenzime ne deklarate e tatim fitimit ne shumen 33.151.313 leke**

**HARTUESI**

**Financier**

**Blerina ALLA**


